

FATF



STANDARDET NDËRKOMBËTARE MBI  
PASTRIMIN E PARAVE LUFTIMIN DHE  
FINANCIMIN E TERRORIZMIT

**Rekomandimet e FATF**

Përditësuar në Qershor 2019

## Rekomandimet e FATF

Numri	Numri i vjetër	
<b>A.POLITIKAT PPP/FT DHE KOORDINIMI</b>		
1	-	Vlerësimi i risqeve dhe aplikimi i një metode të bazuar në risk
2	R.31	Bashkëpunimi dhe koordinimi kombëtar
<b>B. PASTRIMI I PARAVE DHE KONFISKIMI</b>		
3	R.1 & R.2	Vepra e pastrimit të parave
4	R.3	Konfiskimi dhe masat e përkohshme
<b>C. FINANCIMI I TERRORIZMIT DHE FINANCIMI I PËRHAPJES</b>		
5	SRII	Vepra e financimit të terrorizmit
6	SRIII	Sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit.
7	-	Sanksionet specifike financiare të të lidhura me perhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.
8	SRVIII	Organizatat jo-fitimprurëse
<b>D. MASAT PARANDALUESE</b>		
9	R.4	Ligjet e sekretit për institucionet financiare
10	R.5	Kujdesi i duhur klientit*
11	R.10	Mbajtja e të dhënave
12	R.6	Personat e ekspozuar politikisht (PEP)
13	R.7	Bankat korrespondente
14	SR.VI	Shërbimet e transfertave të parave apo vlerave
15	R.8	Teknologjitë e reja
16	SR.VII	Transfertat bankare
17	R.9	MBËSHTETJA, KONTROLLET DHE GRUPET FINANCIARE
18	R.15 & R.22	Mbështetja në palët e treta
19	R.21	Kontrollet e brëndshme dhe degët/filialet e jashtme
20	R.13 & SRIV	Vendet me rrezik të lartë
21	R.14	RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE TË DYSHIMTA
22	R.12	Raportimi i transaksioneve të dyshimta
23	R.16	Zbulimi dhe konfidencialiteti
24	R.33	BIZNESET DHE PROFESIONET JO-FINANCIARE
25	R.34	Bizneset dhe profesionet jo-financiare: Kujdesi i duhur ndaj klientit
26	R.23	DNFBP: masat e tjera
<b>E.TRANSARENCA DHE PRONËSIA PËRFITUESE E PERSONAVE JURIDIK DHE MARRËVESHJEVE LIGJORE</b>		
27	R.29	Transparenca dhe pronësia përfituese e personave juridikë
28	R.24	Transparenca dhe pronësia përfituese e marrëveshjeve ligjore
<b>F.KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E AUTORITETEVE KOMPETENTE DHE MASAT E TJERA INSTITUCIONALE</b>		
29	R.26	RREGULLIMI DHE KONTROLI
30	R.27	Rregullimi dhe mbikëqyrja e institucioneve financiare*
31	R.28	Kompetencat e mbikëqyrësve
32	SR.IX	Rregullimi dhe mbikëqyrja e DNFBPs
33	R.32	OPERACIONALE DHE ZBATIMI LIGJIT
34	R.25	Njësitë e Inteligjencës Financiare*
35	R.27	Përgjegjësitë e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe atyre hetimore*
36	R.28	Kompetencat e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe atyre hetimore.
37	SR.IX	Korrierët e parasë*
38	R.32	KËRKESA TË PËRGJITHSHME
39	R.32	Statistikat
40	R.25	Udhëzime dhe reagimet

STANDARTET NDËRKOMBËTARE MBI LUFTËN KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT  
SANKSIONET

35	R.17	Sanksionet
<b>G. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR</b>		
36	R.35 & SRI	Instrumentet ndërkombëtare
37	R.36 & SRV	Ndihma e ndërsjellë ligjore
38	R.38	Ndihma e ndërsjellë ligjore: ngrirja dhe konfiskimi*
39	R.39	Ekstradimi
40	R.40	Forma të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar*

## HYRJE

Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF) është një organ ndërqeveritar i themeluar në vitin 1989 nga Ministrat e vendeve anëtare. Mandati i FATF është të përcaktojë standardet dhe të nxisë zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative dhe operacionale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar. FATF, në bashkëpunim me organizma të tjerë ndërkombëtar, punon gjithashtu për të identifikuar dobësitë në nivel kombëtar me qëllim mbrojtjen e sistemit financiar ndërkombëtar nga keqpërdorimi.

Rekomandimet e FATF përcaktojnë një kuadër gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të masave që vendet duhet të zbatojnë për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Vendet kanë korniza ligjore administrative, operacionale dhe sisteme financiare të ndryshme dhe si pasojë jo të gjithë mund të marrin masa të njëjta për t'iu kundërvënë këtyre kërcënimeve. Rekomandimet e FATF, përcaktojnë standarte ndërkombëtare, të cilat duhet të zbatohen nga vendet anëtare me anë të masave të që ju përshtaten rrethanave të tyre të veçanta. Rekomandimet e FATF përcaktojnë masat thelbësore që vendet anëtare duhet të kenë në vend në mënyrë që:

- të identifikojnë rreziqet dhe të zhvillojnë politika dhe koordinim në nivel vendi;
- të ndjekin pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes;
- të zbatojnë masa parandaluese për sektorin financiar dhe sektorë të tjerë;
- të përcaktojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e autoriteteve kompetente (p.sh., hetimor, të zbatimit të ligjit dhe autoritetet mbikqyrëse) dhe masa të tjera institucionale;
- të rrisin transparencën dhe disponueshmërinë e informacionit të pronarit përfitues të personave juridikë dhe marrëveshjeve ligjore;
- të mbështesin bashkëpunimin ndërkombëtar.

Dyzet Rekomandimet e FATF janë hartuar në vitin 1990, si një iniciativë për të luftuar keqpërdorimin e sistemeve financiare për pastrimin e parave të drogës. Në vitin 1996 rekomandimet u rishikuan për herë të parë për të pasqyruar tendencat dhe teknikat në ndryshim e sipër të pastrimit të parave dhe për të zgjeruar fushëveprimin e tyre përtej pastrimit të parave të drogës. Në tetor 2001 FATF, zgjeroi mandatin e saj për tu marrë edhe me çështjen e financimit të akteve terroriste dhe organizatave terroriste dhe ndër morri një hap të rëndësishëm për krijimin e tetë (më vonë u zgjeruan në nëntë) Rekomandimeve Speciale për financimin e terrorizmit. Rekomandimet e FATF u rishikuan për herë të dytë në vitin 2003, të cilat së bashku me Rekomandimet Speciale, janë miratuar nga mbi 180 vende dhe janë njohur globalisht si standarte ndërkombëtar për luftën kundër pastrimit të parave dhe Financimit të Terrorizmit (PPP/FT).

Pas përfundimit të raundit të tretë të vlerësimeve të ndërsjella të anëtarëve të saj, FATF ka rishikuar dhe përditësuar Rekomandimet e saj, në bashkëpunim të ngushtë me organizmat rajonal të ngjashëm me FATF (FSRB - FATF Style Regional Bodies) dhe organizatat vëzhguese duke përfshirë Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore dhe Kombet e Bashkuara.

Rishikimet synojnë përballjen me kërcënimet e reja dhe ato në zhvillim, duke sqaruar dhe forcuar shumë prej detyrimeve ekzistuese, si dhe duke ruajtur stabilitetin e nevojshëm dhe rreptësinë e Rekomandimeve.

Standardet e FATF janë rishikuar edhe për të forcuar masat për situata me rrezik të lartë dhe për të lejuar vendet për të marrë një qëndrim më të përqëndruar në drejtimit ku rreziqet janë të larta ose ku zbatimi i këtyre rekomandimeve mund të rritet. Vendet duhet së pari të identifikojnë, vlerësojnë dhe kuptojnë rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që ata hasin dhe pastaj të miratojnë masat e duhura për të zbutur rrezikun. Qasja e bazuar në rrezikun, ju lejon vëndeve anëtare, brënda kuadrit të kërkesave të FATF, të miratojnë një sërë masash më të lakueshme, në mënyrë që të planifikojnë burimet e tyre në mënyrë me efektive dhe të zbatojnë masa parandaluese që janë në përpjesëtim me natyrën e rreziqeve, për të përqëndruar përpjekjet e tyre sa më efektivisht.

Lufta kundër financimit të terrorizmit është një sfidë shumë e rëndësishme. Një sistem efektiv PPP/ FT, në përgjithësi, është i rëndësishëm për përballjen e financimit të terrorizmit, dhe shumica e masave të përqëndruara më parë në financimin e terrorizmit janë integruar tani në të gjitha Rekomandimet, për të shmangur nevojën për rekomandime të posaçme.

Megjithatë, ekzistojnë disa rekomandime që janë të veçantë për financimin e terrorizmit, të cilët janë përcaktuar në kreun C të Rekomandimeve të FATF. Këto janë: Rekomandimi 5 (penalizimi i financimit të terrorizmit); Rekomandimi 6 (sanksionet financiare që lidhen me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit) dhe Rekomandimi 8 (masat për të parandaluar keqpërdorimin e organizatave jofitimprurëse). Përhapja e armëve të shkatërrimit në masë përbën gjithashtu një shqetësim të rëndësishëm për sigurinë dhe mandati i FATF u zgjerua në vitin 2008, për të përfshirë masa që kanë të bëjnë me financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Për të luftuar këtë kërcënim, FATF ka miratuar një Rekomandim të ri (Rekomandimi 7) i cili synon sigurimin e zbatimit të qëndrueshëm dhe efektiv të sanksioneve financiare, kur këto kërkohen nga Këshilli i Sigurimit të OKB.

Standardet e FATF përfshijnë rekomandimet dhe Shënimet e tyre Shpjeguese, së bashku me përkufizimet përkatëse në Fjalor. Masat e përcaktuara në Standardet e FATF duhet të zbatohen nga të gjithë anëtarët e FATF dhe FSRBs, dhe zbatimi i tyre vlerësohet me rreptësi përmes proceseve të Vlerësimit të Ndërsjellë (*Mutual Evaluation*), proceseve të vlerësimit të Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore - mbi bazën e metodologjise së vlerësimit të përbashkët të FATF. Disa shënime shpjeguese dhe përkufizime në fjalor përfshijnë shëmbuj të cilët sqarojnë mënyrën e zbatimit të detyrimeve. Këta shëmbuj nuk janë elemente të detyrueshem të standarteve të FATF dhe janë përfshirë vetëm për efekte udhëzimi. Shëmbujt nuk kanë natyrë gjithëpërfshirëse edhe pse shikohen si tregues të dobishëm ata nuk mund të jenë të zbatueshëm në të gjitha rrethanat.

FATF gjithashtu përgatit udhëzime, dokumente të praktikave më të mira dhe këshilla të tjera për të ndihmuar vendet anëtare në zbatimin e standarteve. Këto dokumente nuk janë të detyrueshme për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet, por vendet mund ti marrin parasysh në drejtim të zbatimit sa më të mirë të tyre. Një listë e Udhëzimeve aktuale të FATF dhe praktikave më të mira, të cilat janë publikur në faqen e internetit të FATF, janë përfshirë si një aneks i Rekomandimeve.

FATF është i angazhuar në drejtim të një dialogu të ngushtë dhe dobiprurës me sektorin privat, shoqërinë civile dhe palët e tjera të përfshira, si partnerë të rëndësishëm në sigurimin e integritetit të sistemit financiar. Rishikimi i rekomandimeve është shoqëruar me një këshillim të gjerë me këta aktor dhe ka përfituar nga komentet dhe sugjerimet e tyre. Në të ardhmen FATF në përputhje me mandatin e tij, do të vazhdojë të shqyrtojë ndryshimet të standarteve, sipas zhvillimeve dhe bazuar në të dhënat për kërcënimet e reja dhe dobësitë globale të sistemit financiar.

FATF i bën thirrje të gjitha vendeve për të zbatuar masa efektive për sistemet e tyre kombëtar për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimin të përhapjes, në përputhje me rekomandimet e rishikuara.

## REKOMANDIMET E FATF

### A.POLITIKAT PPP/FT DHE KOORDINIMI

#### 1. Vlerësimi i risqeve dhe aplikimi i një metode të bazuar në risk

Vendet duhet të identifikojnë, vlerësojnë dhe të kuptojnë rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për vendin dhe duhet të marrin masa, duke përfshirë caktimin e një autoriteti ose mekanizmi për të koordinuar veprimet për vlerësimin e rreziqeve, dhe të përdorin burimet, që synojnë sigurimin reduktimin e rreziqeve në mënyrë efektive. Bazuar në këtë vlerësim, vendet duhet të zbatojnë një qasje të bazuar në rrezikun (QBR) për të siguruar që masat për parandalimin ose zvogëlimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë në përputhje me rreziqet e identifikuara. Kjo qasje duhet të përbëjë themelin e përdorimit efikas të burimeve në regjimin e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (LKPP/FT) dhe në zbatimin masave të bazuara në rrezikun për të gjitha Rekomandimet e FATF. Kur vendet diktojnë nivele më të larta rreziku, ato duhet të sigurohen se regjimi i tyre i LKPP/ PP i përballon në mënyrën e duhur këto rreziqe. Kur vendet diktojnë rreziqe më të ulëta, në kushte të caktuara ato mund të vendosin të lejojnë masa të thjeshtuara për disa nga Rekomandimet FATF. Vendet gjithashtu duhet të identifikojnë, vlerësojnë dhe kuptojnë rreziqet e tyre të financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Në kuadrin e Rekomandimit 1, “rreziku i financimit të përhapjes” i referohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë vetëm shkeljes, moszbatimit ose shmangies së mundshme të detyrimeve të sanksioneve financiare të parashikuara në Rekomandimin 7. Vendet duhet të ndërmarrin veprime proporcionale, me të cilat të synojnë të sigurojnë që këto rreziqe zvogëlohen në mënyrë efektive, duke përfshirë caktimin e një autoriteti ose mekanizmi për të koordinuar veprimet për të vlerësuar rreziqet dhe caktimin e burimeve në mënyrë efikase për këtë qëllim. Kur vendet identifikojnë rreziqe më të larta, ato duhet të sigurojnë që ato trajtohen në mënyrë të përshtatshme. Kur vendet identifikojnë rreziqe më të ulëta, ato duhet të sigurojnë që masat e zbatuara janë në përputhje me nivelin e rrezikut të financimit të përhapjes, duke siguruar njëkohësisht zbatimin e plotë të sanksioneve financiare të parashikuara në Rekomandimin 7.

Vendet duhet t’u kërkojnë institucioneve financiare dhe bizneseve e profesioneve jo-financiare (DNFBP) të njohin, vlerësojnë dhe të marrin masa efektive për të zvogëluar rreziqet e tyre në fushën e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe armëve të shkatërrimit në masë.

#### 2. Bashkëpunimi dhe koordinimi kombëtar

Vendet duhet të kenë politika kombëtare të PPP/FT dhe financimit të përhapjes, të bazuar në risqet e identifikuara të cilat duhet të rishikohen rregullisht dhe duhet të caktojnë një autoritet apo të kenë një koordinim apo mekanizëm përgjegjës për këto politika.

Vendet duhet të sigurohen që hartuesit e politikave, Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF), autoritetet e

zbatimit të ligjit, mbikqyrësit dhe autoritetet tjera kompetente, në hartimin e politikave dhe nivelet operative, kanë mekanizma efektive që ju mundësojnë atyre të bashkëpunojnë dhe kur është e përshtatshme, të koordinojnë dhe shkëmbejnë informacion në nivel vëndi me njëri-tjetrin në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe aktiviteteve për të luftuar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Kjo duhet të përfshijë bashkëpunimin dhe koordinimin midis autoriteteve përkatëse për të siguruar përputhshmërinë e kërkesave të PPP/ FT dhe financimit të përhapjes, me rregullat e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë apo dispozitave të tjera të ngjashme (p.sh. siguria e të dhënave/vendndodhja).

## **B. PASTRIMI I PARAVE DHE KONFISKIMI**

### **3. Vepra e pastrimi të parave**

Vendet duhet të dënojnë pastrimin e parave në bazë të Konventës së Vjenës dhe asaj të Palermos. Vendet duhet të aplikojnë krimin e pastrimit të parave ndaj të gjitha krimet e rënda, me synimin për të përfshirë një gamë sa më të gjerë të veprave penale të origjinës.

### **4. Konfiskimi dhe masat e përkohshme**

Vendet duhet të adoptojnë masa të ngjashme me ato të përcaktuara në Konventën e Vjenës, Konventën e Palermos, dhe Konventën e Financimit të Terrorizmit, duke përfshirë masat legislative, për të mundësuar autoritetet e tyre kompetente që të ngrijnë, sekuestrojnë dhe konfiskojnë ato që paraqiten më poshtë, pa cënuar të drejtat e palëve të treta në mirëbesim: (a) pasurinë që i nënshtrohet pastrimit, (b) produkte nga, ose instrumente që përdoren në ose janë të destinuara për t'u përdorur në pastrimin e parave ose kryerjen e veprave të origjinës (c) pasuri që përbën produkte të krimin, ose që rrjedh nga, përdorur në, ose e destinuar apo caktuar për përdorim në financimin e terrorizmit, aktet terroriste apo organizatat terroriste, ose (d) pasuri me vlerë të barabartë.

Masa të tilla duhet të përfshijnë autoritetin për:(a) të identifikuar, gjurmuar dhe vlerësuar pasurinë që i nënshtrohet konfiskimit,(b) të marrë masa të përkohshme, të tilla si ngrirja dhe konfiskimi, për të parandaluar, shitjen, transferimin ose shitblerjen e një prone të tillë; (c) të marrë hapat që do të parandalojnë ose anullojnë veprimet të cilat pengojnë aftësinë e vendit për të ngrirë, sekuestruar apo rimarrë pronën që është subjekt i konfiskimit dhe (d) të ndërmarrin masat e duhura hetimore.

Vendet duhet të marrin parasysh miratimin e masave që lejojnë të ardhurat e tilla ose instrumentet që të konfiskohen pa kërkuar një dënim penal (konfiskimi jo i bazuar në dënim), ose të cilat kërkojnë që një kundravajtës të provojë origjinën e ligjshme të pasurisë që supozohet të jetë objekt konfiskimi, deri në masën që një kërkesë e tillë është në përputhje me parimet e legjislacionit vendas.

## **C. FINANCIMI I TERRORIZMIT DHE FINANCIMI I PËRHAPJES**

### **5. Vepra e financimit të terrorizmit**

Vendet duhet të penalizojnë financimin e terrorizmit mbi bazën e Konventës së Financimit të Terrorizmit, dhe duhet të penalizojnë jo vetëm financimin e akteve terroriste, por edhe financimin e

STANDARTET NDËRKOMBËTARE MBI LUFTËN KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT  
organizatave terroriste dhe terroristët individualë edhe në mungesë të një lidhjeje me një akt/akte terroriste specifike. Vendet duhet të sigurojnë se vepra të tilla janë përcaktuar si vepra penale të origjinës për pastrimin e parave.

## 6. Sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit

Vendet duhet të zbatojnë sanksione financiare specifike, në përputhje me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, që lidhen me parandalimin dhe goditjen e terrorizmit dhe financimit të tij. Rezolutat u kërkojnë vendeve që të ngrijnë pa vonesë fondet apo pasuritë e tjera dhe të sigurohen se fondet apo pasuritë e tjera nuk vihen në dispozicion, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte, drejt ose në përfitim të, çdo personi ose subjekti qoftë (i) i përcaktuar nga, ose nën autoritetin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nën Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë në përputhje me rezolutën 1267 (1999) dhe rezolutat pasardhëse të saj, ose (ii) i shpallur nga ai vend në përputhje me Rezolutën 1373 (2001).

## 7. Sanksionet specifike financiare të lidhura me perhapjen e armëve të shkatërrimit në masë

Vendet duhet të zbatojnë sanksione specifike financiare në përputhje me Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me parandalimin, goditjen, shtypjen dhe pengimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe financimin e tyre. Këto rezoluta u kërkojnë vendeve të ngrijnë pa vonesë fondet apo pasuritë e tjera dhe të sigurohen se nuk ka fonde apo pasuri të tjera në dispozicion, drejtpërdrejt ose indirekt, drejt ose në përfitim të, çdo personi ose subjekti të shpallur nga, ose nën autoritetin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara bazuar në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

## 8. Organizatat jo-fitimprurëse

Vendet duhet të shqyrtojnë përshtatshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me organizatat jo-fitim prurëse, të cilat janë identifikuar si të cënueshme ndaj abuzimit për financim të terrorizmit. Ndaj këtyre organizatave, vendet duhet të zbatojnë masa të përqëndruara dhe përpjestimore, në përputhje me qasjen e bazuar në rrezik, për t'i mbrojtur ato nga abuzimi për financim të terrorizmit përfshirë:

- (a) nga organizatat terroriste që paraqiten si subjekte legjitime;
- (b) për të shfrytëzuar subjekte legjitime si ndërmjetëse për financimin e terrorizmit, përfshirë këtu qëllimin për t'ju shmangur masave të ngrirjes së pasurive;
- (c) për të fshehur ose mbuluar zhvendosjen e fondeve të paracaktuara për qëllime të ligjshme, tek organizatat terroriste.

## D. MASAT PARANDALUESE

### 9. Ligjet e sekretit për institucionet financiare

Vendet duhet të sigurojnë që ligjet e sekretit të institucioneve financiare nuk pengojnë zbatimin e Rekomandimeve të FATF.

KUJDESI NDAJ KLIENTIT DHE MBAJTJA E TË DHËNAVE



## 10. Kujdesi i duhur klientit

Institucioneve financiare duhet t'ju ndalohet mbajtja e llogarive anonime ose llogarive me emra të dukshëm fiktivë. Institucioneve financiare duhet t'ju kërkohet të ndërmarrin masa të kujdesit të duhur ndaj klientit (KDK) në rastet kur:

- (i) vendosin marrëdhënie biznesi;
- (ii) kryejnë transaksione rastësore: (i) mbi pragun e përcaktuar (15,000 USD / EUR); ose (ii) që janë transfera në rrethana të përcaktuara nga shënimi interpretues i Rekomandimit 16;
- (iii) ekziston dyshimi i pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit, ose;
- (iv) institucioni financiar ka dyshime në lidhje me vërtetësinë ose përshtatshmërinë e të dhënave identifikuese të klientit të përfuara më parë.

Parimi që institucionet financiare duhet të kryejnë KDK duhet të përcaktohet në ligj. Çdo vend mund të përcaktojë se si të zbatojë detyrimet specifike të KDK, qoftë nëpërmjet ligjit ose akteve të detyrueshme.

Në funksion të KDK do të ndërmerren masat e më poshtëme:

- (a) Identifikimi i klientit dhe verifikimi i identitetit të tij duke përdorur dokumente të dhëna apo informacione nga burime të besueshme e të pavarura;
- (b) Identifikimi i pronarit përfitues, si dhe marrja e masave të arsyeshme për verifikimin dhe identifikimin e pronarit përfitues, të tilla që institucioni financiar është i bindur se e di se kush është pronari përfitues. Për personat juridikë dhe marrëveshjet ligjore kjo duhet të përfshijë të kuptuarit nga institucionet financiare të pronësisë dhe strukturës së kontrollit të klientit.
- (c) Kuptimi dhe sipas rastit, përftimi i informacionit mbi qëllimin dhe natyrën e marrëdhënies së biznesit;
- (d) Kryerja në mënyrë të vazhdueshme të kujdesit të duhur në marrëdhënien e biznesit dhe shqyrtimit të transaksioneve të ndërmarra gjatë gjithë kësaj marrëdhënie për të siguruar që transaksionet e kryera janë përputhje me njohuritë e institucionit për klientin, biznesit të tij dhe profilit të rrezikut, duke përfshirë, kur është e nevojshme dhe burimin e fondeve.

Institucioneve financiare duhet t'u kërkohet të zbatojnë secilën prej masave të KDK sipas pikës (a) - (d) më lart, por duhet të përcaktojnë shtrirjen e këtyre masave duke përdorur një qasje të bazuar në rrezikun (QBR), në përputhje me Shënimet Shpjeguese të këtij Rekomandimi dhe të Rekomandimit 1.

Institucioneve financiare duhet t'u kërkohet të verifikojnë identitetin e klientit dhe të pronarit përfitues para ose gjatë kohës së krijimit të një marrëdhënie biznesi apo të kryerjes së transaksioneve për klientë të rastit. Vendet mund të lejojnë institucionet financiare që të përfundojnë verifikimin sa më shpejt që është e mundur pas vendosjes së marrëdhënies, kur rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit administrohen në mënyrë efektive dhe kur kjo është e domosdoshme për të mos ndërprerë

Kur institucioni financiar nuk është në gjëndje të përmbushë kërkesat e zbatueshme në paragrafët (a) dhe (d) më sipër (subjekt i modifikimit të duhur të shtrirjes së masave mbi një qasje të bazuar në rrezikun), i kërkohet të mos hapë llogari, të fillojë një marrëdhënie biznesi apo të kryejë transaksionin; ose duhet t'i kërkohet që të ndërpresë marrëdhënien e biznesit dhe duhet të shqyrtojë përgatitjen e një raporti transaksionesh të dyshimta në lidhje me klientin.

Këto kërkesa duhet të zbatohen për të gjithë klientët e rinj dhe institucionet financiare duhet gjithashtu të aplikojnë këtë rekomandim për klientët ekzistues mbi bazën e rrethanave dhe rrezikut, dhe duhet të tregojnë kujdes për marrëdhënie të tilla ekzistuese në kohë të përshtatshme.

## 11. Mbajtja e të dhënave

Institucioneve financiare u kërkohet që të ruajnë, për të paktën pesë vjet, të gjitha të dhënat e nevojshme mbi transaksionet, si brënda vendit ashtu dhe ato ndërkombëtare, për t'u mundësuar atyre që t'ju përgjigjen sa më shpejt kërkesave për informacion nga autoritetet kompetente. Këto të dhëna duhet të jenë të mjaftueshme për të lejuar rindërtimin e transaksioneve individuale (përfshirë shumat dhe llojet e monedhës së përfshirë, nëse ka ndonjë) në mënyrë që të sigurojë, nëse është e nevojshme, fakte për hetimin e veprimtarisë kriminale.

Institucionet financiare duhet të mbajnë të gjitha të dhënat e përftuara nëpërmjet masave të KDK (p.sh. kopje ose të dhëna të dokumenteve zyrtare të identifikimit si pasaporta, kartat e identitetit, patenta ose dokumente të ngjashme), dosje të llogarisë dhe korrespondencën e biznesit, duke përfshirë rezultatet e çdo analize të kryer (p.sh. hetimet për të kuptuar sfondin dhe qëllimin e transaksioneve komplekse, në shumata të pazakonta), për të paktën pesë vjet nga përfundimi i marrëdhënies së biznesit, ose pas datës së transaksionit të rastit.

Institucioneve financiare duhet t'ju kërkohet me ligj që të ruajnë të dhënat për transaksionet dhe informacionet e përftuara nëpërmjet masave të KDK. Informacioni i KDK dhe të dhënat e transaksionit duhet të jenë në dispozicion të autoriteteve kompetente vendase bazuar në autoritetin përkatës.

## MASA SHITESË PËR KLIENTË DHE AKTIVITETE TË VEÇANTA

### 12. Personat e ekspozuar politikisht (PEP)

Lidhur me personat e ekspozuar politikisht (PEP) të huaj (qoftë si klient apo pronar përfitues), institucionet financiare përveç kryerjes së masave normale të kujdesit të duhur ndaj klientit, duhet të:

- (a) kenë sisteme të përshtatshme të administrimit të riskut për të përcaktuar nëse klienti apo pronari përfitues është person i ekspozuar politikisht;
- (b) të marrin aprovim nga niveli i lartë i drejtimit për të vendosur (apo vazhduar, për klientët ekzistues) marrëdhënie të tilla biznesi;
- (c) të marrin masa të arsyeshme për të përcaktuar burimin e pasurisë dhe burimin e fondeve ;si dhe

(d) të kryejnë monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit.

Institucionet financiare duhet të marrin masa të arsyeshme për të përcaktuar nëse një klient apo pronar përfutues është një PEP vendas apo një person të cilit i është ose i ka pas qenë besuar një funksion i rëndësishëm nga një organizatë ndërkombëtare. Në rastet e një marrëdhënieje biznesi të rrezikut të lartë me persona të tillë, institucioneve financiare duhet t'ju kërkohet të zbatojnë masat e përcaktuara në paragrafët (b), (c) dhe (d).

Kërkesat për të gjithë llojet e PEP-ave duhet të zbatohen edhe për familjarët ose bashkëpunëtorët e ngushtë.

### 13. Bankat korrespondente

Në lidhje me marrëdhëniet bankare korrespondente ndërkufitare dhe marrëdhëniet e tjera të ngjashme, institucioneve financiare duhet t'u kërkohet që përveç marrjes së masave normale të kujdesit të duhur ndaj klientit të:

- (a) mbledhin informacion të mjaftueshëm për një institucion korrespondent për të kuptuar plotësisht natyrën e tij të biznesit dhe të përcaktojnë nga informacione në dispozicion të publikut reputacionin e institucionit dhe cilësinë e mbikëqyrjes, përfshirë këtu nëse ai ka qenë subjekt i një hetimi apo akti rregullator për pastrim parash apo financim terrorizmi;
- (b) vlerësojnë kontrollat e PPP/FT të institucionit korrespondent;
- (c) të marrë miratimin nga niveli i lartë i drejtimit para se të vendosë marrëdhënie të reja korrespondente;
- (d) të kuptojë qartë përgjegjësitë përkatëse të secilit institucion; dhe
- (e) në lidhje me "llogaritë tranzitore", të sigurohet që banka korrespondente ka kryer KDK për klientët të cilët kanë qasje të drejtpërdrejtë në llogaritë e saj dhe se ajo është në gjendje që sipas kërkesës të sigurojë informacionin përkatës për KDK.

Institucioneve financiare duhet t'u ndalohet vendosja ose vazhdimi i marrëdhënieve bankare korrespondente me bankat guackë. Institucionet financiare duhet të sigurohen që institucionet korrespondente nuk lejojnë llogaritë e tyre të përdoren nga bankat guackë.

### 14. Shërbimet e transfertave të parave apo vlerave

Vendet duhet të marrin masa për të siguruar që personat fizikë ose juridikë që ofrojnë shërbimet e transfertave të parave apo vlerave (SHTPV) janë të licencuar ose rregjistruar dhe janë subjekt i sistemeve efektive për mbikëqyrjen dhe sigurimin e përputhshmërisë me masat përkatëse të përcaktuara në Rekomandimet e FATF. Vendet duhet të marrin masa për të identifikuar personat fizikë apo juridikë që kryejnë SHTPV pa licensë apo regjistrim, si dhe të zbatojnë sanksionet e duhura.

Çdo person fizik ose juridik që punon si agjent duhet të jetë i licencuar ose i rregjistruar nga një autoritet kompetent, ose ofruesi i SHPTV duhet të mbajë një listë aktuale të agjentëve të saj e cila vihet në dispozicion të autoriteteve kompetente në vendet në të cilat veprojnë ofruesi i SHPTV dhe agjentët e tij. Vendet duhet të marrin masa për të siguruar që ofruesit e SHPTV që përdorin agjentë, t'i përfshijnë ata në programet e tyre të PPP/FT dhe t'i mbikëqyrin për përputhshmëri me këto programe.

### 15. Teknologjitë e reja

Vendet dhe institucionet financiare duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë rreziqet e pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit që mund të lidhen me (a) zhvillimin e produkteve të reja dhe praktikave të reja të biznesit, duke përfshirë mekanizmat e ri të shpërndarjes, (b) përdorimin e teknologjive të reja apo në zhvillim, edhe për produktet e reja edhe për ato ekzistuese. Në rastin e institucioneve financiare, një vlerësim i tillë i rrezikut duhet të bëhet para vënies në përdorim të produkteve të reja, praktikave të biznesit apo përdorimit të teknologjive të reja ose në zhvillim. Ato duhet të marrin masat e duhura për të administruar dhe për të zvogëluar këto rreziqe.

Për të administruar dhe zbutur rreziqet që rrjedhin nga mjetet virtuale, vendet duhet të sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të tyre të rregullohen për qëllime të PPP/ FT, të licencohen ose regjistrohen dhe t'ju nënshtrohen sistemeve efektive për mbikëqyrjen dhe sigurimin e përputhshmërisë me masat e kërkuara nga Rekomandimet e FATF.

## 16. Transfertat bankare

Vendet duhet të sigurojnë që institucionet financiare përfshijnë informacionin e duhur dhe të saktë të iniciuesit, dhe informacionin e kërkuar të përfituesit, në transfertat dhe mesazhet që lidhen me to dhe se informacioni shoqëron transfertat bankare apo mesazhet e tyre gjatë gjithë zinxhirit të pagesës.

Vendet duhet të sigurojnë që institucionet financiare vëzhgojnë transfertat bankare për qëllime të zbulimit të atyre që u mungon informacioni i iniciuesit dhe/ose përfituesit dhe të marrin masat e nevojshme.

Vendet duhet të sigurojnë që, në kuadrin e përpunimit të transfertave, institucionet financiare marrin masa të ngrirjes dhe duhet të ndalojnë kryerjen e transaksioneve me persona të shpallur dhe subjekte, sipas detyrimeve të përcaktuara në rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të tilla si rezoluta 1267 (1999) dhe rezolutat e saj pasardhëse, si dhe rezoluta 1373 (2001), në lidhje me parandalimin dhe goditjen e terrorizmit dhe financimit të terrorizmit.

## MBËSHTETJA, KONTROLLET DHE GRUPET FINANCIARE

### 17. Mbështetja në palët e treta

Vendet mund të lejojnë institucionet financiare që të mbështeten në palët e treta për të kryer elementet (a) - (c) të masave të KDK, të përcaktuara në Rekomandimin 10 apo për të prezantuar biznesin, me kusht që të jenë plotësuar kriteret e përcaktuara më poshtë. Në rastet kur një mbështetje e tillë lejohet, përgjegjësia për masat e KDK i mbetet institucionit financiar që mbështetet në palën e tretë:

Kriteret që duhet të përmbushen janë si më poshtë:

(a) Një institucion financiar që mbështetet në një palë të tretë duhet menjëherë të marrë informacionin e nevojshëm përsa u përket elementeve (a) - (c) të masave të KDK, të përcaktuara në Rekomandimin 10.

(b) Institucionet financiare duhet të marrin hapat e duhura për t'u siguruar se kopjet e të dhënave identifikuese dhe dokumentacioni tjetër përkatës në lidhje me detyrimet e KDK, do të vihen në

STANDARTET NDËRKOMBËTARE MBI LUFTËN KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT  
dispozicion pa vonesë nga pala e tretë, sipas kërkesës.

(c) institucioni financiar duhet të sigurohet se pala e tretë është rregulluar, mbikëqyrur ose vëzhguar dhe ka marrë masa për përputhjen me kërkesat e KDK dhe ruajtjen e të dhënave sipas rekomandimeve 10 dhe 11.

(d) Gjatë përcaktimit se në cilin vend mund të bazohet pala e tretë që plotëson kushtet, vendet duhet të kenë parasysh informacionin në dispozicion sipas nivelit të rrezikut të atij vendi.

Kur një institucion financiar mbështetet në një palë të tretë që është pjesë e të njëjtit grup financiar, dhe (i) ai grup i zbaton kërkesat e KDK dhe mbajtjen e të dhënave, në përputhje me rekomandimet 10, 11 dhe 12, si dhe programet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me Rekomandimin 18; dhe (ii) ku zbatimi efektiv i atyre kërkesave të KDK, mbajtjes së të dhënave dhe programet e PPP/FT në nivel grupi mbikqyren nga një autoritet kompetent, atëherë autoritetet kompetente përkatëse mund të marrin në konsideratë se institucioni financiar zbaton masat sipas pikës (b) dhe (c) më lart përmes programit të tij në nivel grupi dhe mund të vendosë se (d) nuk është një parakusht i nevojshëm për mbështetje kur rreziku më i lartë në nivel vendi është kufizuar në mënyrën e duhur nga politikat PPP/FT në nivel grupi.

## 18. Kontrollat e brëndshme dhe degët/filialet e huaja

Institucionet financiare duhet të zbatojnë programe kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Grupet financiare duhet të zbatojnë në nivel grupi programe kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë politikat dhe procedurat për komunikimin e brëndshëm të informacionit për qëllimet PPP/FT.

Institucionet financiare duhet të sigurojnë që në degët e tyre të huaja dhe filialet në të cilat zotërojnë shumicën e aksioneve, të aplikojnë masat e PPP/FT në përputhje me kërkesat e vendit të origjinës duke zbatuar rekomandimet e FATF, nëpërmjet programeve të grupit financiar kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

## 19. Vendet me rrezik të lartë

Institucionet financiare duhet të aplikojnë masat e vigjilencës së zgjeruar për marrëdhëniet e biznesit dhe transaksioneve me personat fizikë dhe juridikë, si dhe institucionet financiare të vëndeve shpallura nga FATF. Lloji i masave të zbatueshme të vigjilencës së zgjeruar duhet të jetë efektiv dhe në përpjestim me rreziqet.

Vendet duhet të jenë në gjendje të zbatojnë kundërmasat e duhura, kur një gjë e tillë kërkohet nga FATF. Vendet duhet gjithashtu të jenë në gjendje të zbatojnë kundërmasa pavarësisht nga sa kërkohet nga FATF. Kundërmasat e tilla duhet të jenë efektive dhe në përpjestim me rreziqet.

## RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE TË DYSHIMTA

### 20. Raportimi i transaksioneve të dyshimta

Institucionit financiar duhet t'i kërkohet me ligj që nëse dyshon ose ka baza të arsyeshme për të dyshuar

STANDARTET NDËRKOMBËTARE MBI LUFTËN KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT  
se fondet janë produkte të një aktiviteti kriminal, ose lidhen me financimin e terrorizmit, të raportojë menjëherë dyshimin e tij në Njësinë e Inteligjencës Financiare (NJIF).

## 21.Zbulimi dhe konfidencialiteti

Institucionet financiare, drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit e tyre duhet të:

- (a) mbrohen me ligj nga përgjegjësia penale dhe civile për shkelje të ndonjë kufizimi në zbulimin e informacionit të përcaktuar me kontratë apo nga ndonjë dispozitë ligjore, rregullatore apo administrative, në qoftë se ata raportojnë dyshimet e tyre me mirëbesim te NJIF edhe në qoftë se ata nuk e dinë saktësisht se cili ishte aktiviteti kriminal dhe pavarësisht nëse aktiviteti i jashtëligjshëm ka ndodhur në të vërtetë;
- (b) ndalohen me ligj nga njoftimi (*tipping-off*) i faktit se një raport i transaksionit të dyshimtë (RAD) ose informacion i ngjashëm është paraqitur tek NJIF. Këto kërkesa nuk synojnë të pengojnë shkëmbimin e informacionit në përputhje me rekomandimin 18.

## BIZNESET DHE PROFESIONET JO-FINANCIARE

### 22.Bizneset dhe profesionet jo-financiare: Kujdesi i duhur ndaj klientit

Kërkesat për kujdesin e duhur ndaj klientit dhe mbajtjen e të dhënave të përcaktuara në Rekomandimet 10, 11, 12, 15, dhe 17, zbatohen për bizneset dhe profesionet jo-financiare (DNFBPs) në situatat e mëposhtme:

- (a) Kazinotë - kur klientët angazhohen në transaksionet financiare të barabarta me ose mbi pragun e përcaktuar.
- (b) Agjentët e pasurive të patundshme - kur ata janë të përfshirë në transaksione për klientin e tyre përsa i përket blerjes dhe shitjes së pasurive të patundshme.
- (c) Shitësit e metaleve dhe gurëve të çmuar - kur ata përfshihen me një klient në ndonjë transaksion me para në dorë, i cili është i barabartë ose mbi pragun e përcaktuar.
- (d) Avokatët, noterët, profesionistët e tjerë të pavarur ligjorë dhe kontabilistët - kur ata përgatisin ose kryejnë transaksione për klientët e tyre lidhur me aktivitetet e mëposhtme:
  - shit-blerjen e pasurive të paluajtshme;
  - administrimin e parave të klientit, letrave me vlerë ose të pasurive të tjera;
  - administrimin e llogarive bankare, të letrave me vlerë ose pasurive të tjera;
  - organizimin e kontributeve për krijimin, funksionimin ose administrimin e shoqërive;
  - krijimin, funksionimin ose administrimin e personave juridikë ose marrëveshjeve ligjore, dhe shit-blerjen e njësive të biznesit.
- (e) Trustet dhe ofruesit e shërbimeve të kompanisë - kur ata përgatisin ose kryejnë transaksione për një klient në lidhje me aktivitetet e mëposhtme:
  - duke vepruar si një agjent për krijimin e personave juridikë;
  - duke vepruar si (ose ka organizuar që një person tjetër të veprojë si) një drejtor ose sekretar i një kompanie, një partner i një ortakëri, apo një pozitë të ngjashme në lidhje me personat e tjerë

juridikë;

- ofron një zyrë të regjistruar, adresën e biznesit
- ose strehim, korrespondencën ose adresën administrative për një kompani, një ortakëri ose ndonjë person tjetër juridik apo marrëveshje ligjore;
- duke vepruar si (ose ka organizuar që një person tjetër të veprojë si) një administrator i një trusti ekspres\* ose që kryen funksionin ekuivalent për një formë tjetër të marrëveshjes ligjore;
- duke vepruar si (ose ka organizuar që një person tjetër të veprojë si) një aksioner nominal për një person tjetër.

### 23. DNFBP: masat e tjera

Kërkesat e parashtruara në Rekomandimet 18 – 21, zbatohen për të gjitha bizneset dhe profesionet jo-financiare, në përputhje me cilësimet e mëposhtëme:

(a) avokatëve, noterëve, profesionistëve të tjerë të pavarur ligjor dhe kontabilistëve duhet t'ju kërkohet të raportojnë transaksionet e dyshimta, kur angazhohen në emër të ose për një klient në një transaksion financiar në lidhje me aktivitetet e përshkruara në paragrafin (d) të Rekomandimit 22. Vendet inkurajohen të shtrijnë efektin e kërkesës së raportimit për pjesën tjetër të aktiviteteve profesionale të kontabilistëve, duke përfshirë dhe auditimin.

(b) Shtësve të metaleve dhe gurëve të çmuar duhet t'ju kërkohet të raportojnë transaksionet e dyshimta kur përfshihen në ndonjë transaksion (të barabartë ose më të lartë se pragu i përcaktuar) me para në dorë me një klient.

(c) Trustet dhe ofruesit e shërbimeve të kompanive duhet të raportojnë transaksionet e dyshimta për një klient, kur në emër të ose për një klient, ata angazhohen në një transaksion në lidhje me aktivitetet e përcaktuara në paragrafin (d) të Rekomandimit 22.

## **E.TRANSPARENCA DHE PRONËSIA PËRFITUESE E PERSONAVE JURIDIK DHE MARRËVESHJEVE LIGJORE**

### 24. Transparenca dhe pronësia përfituese e personave juridikë

Vendet duhet të marrin masa për të parandaluar shpërdorimin e personave juridik për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit. Vendet duhet të sigurojnë që ekziston informacioni i duhur, i saktë dhe në kohë për pronarin përfitues dhe kontrollin e personave juridikë që mund të merret apo sigurohet në kohën e duhur nga autoritetet kompetente. Në veçanti, vendet që kanë persona juridik që janë në gjendje të lëshojnë aksione të mbajtësit ose garanci të aksioneve të mbajtësit, ose të cilët lejojnë aksionerët ose drejtorët nominal, duhet të marrin masa efektive për të siguruar që ata nuk abuzohen për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit. Vendet duhet të marrin parasysh masat për të lehtësuar qasjen, në pronësinë përfituese dhe informacionin e kontrollit, nga ana e institucioneve financiare dhe DNFBP në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Rekomandimet 10 dhe 22.

### 25. Transparenca dhe pronësia përfituese e marrëveshjeve ligjore

Vendet duhet të marrin masa për të parandaluar keqpërdorimin e marrëveshjeve ligjore, për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit. Në veçanti, vendet duhet të sigurohen që kanë informacion të

mjaftueshëm, të saktë dhe në kohë për trustet ekspres, duke përfshirë informacionin mbi kujdestarin, të mirëbesuarin dhe përfituesit, që mund të merret ose të sigurohet në kohën e duhur nga autoritetet kompetente. Vendet duhet të marrin parasysh masat për të lehtësuar qasjen në informacionin mbi pronësinë e përfituesit dhe kontrollit nga ana e institucioneve financiare dhe DNFBP në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Rekomandimet 10 dhe 22.

## F. KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË E AUTORITETEVE KOMPETENTE DHE MASAT E TJERA INSTITUCIONALE

### RREGULLIMI DHE KONTROLLI

#### 26. Rregullimi dhe mbikëqyrja e institucioneve financiare\*

Vendet duhet të sigurojnë që institucionet financiare janë subjekt i rregullimit dhe mbikëqyrjes adekuate dhe efektive për zbatimin e rekomandimeve të FATF. Autoritetet kompetente ose mbikëqyrësit financiar duhet të marrin masat e nevojshme ligjore ose rregullative për të parandaluar kriminelët apo bashkëpunëtorët e tyre nga pasja apo të qënit pronar përfitues i një interesi të rëndësishëm ose kontrollues, ose mbajtja e një funksioni administrimi në një institucion financiar. Vendet nuk duhet të miratojnë ngritjen ose funksionimin e vazhdueshëm të bankave guackë.

Për institucionet financiare që i nënshtrohen *Parimeve Themelore*<sup>1</sup> të masave rregullatore dhe mbikëqyrëse që zbatohen për qëllime të prudenciale, të cilat kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, duhet të zbatohen në mënyrë të ngjashme në funksion të PPP/FT. Kjo duhet të përfshijë zbatimin në nivel grupi të mbikëqyrjes së konsoliduar në drejtim të PPP/FT.

Institucionet e tjera financiare duhet të jenë të licënuara apo të rregjistruara në mënyrë duhur dhe t'i nënshtrohen mbikëqyrjes apo monitorimit në funksion të PPP/FT, duke pasur parasysh rrezikun e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit në atë sektor. Institucionet financiare që ofrojnë një shërbim të parave ose transferimin e vlerës, apo të këmbimit valutor duhet që minimalisht të jenë të licënuara apo të rregjistruara dhe subjekt i sistemeve efektive për monitorimin dhe sigurimin e përputhshmërisë me detyrimet kombëtare të PPP /FT.

#### 27. Kompetencat e mbikëqyrësve

Mbikëqyrësit duhet të kenë kompetencat e duhura për të mbikëqyrur ose monitoruar dhe për të siguruar përputhshmërinë e institucioneve financiare, me kërkesat për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, duke përfshirë autoritetin për të kryer inspektive. Ata duhet të jenë të autorizuar për marrjen nga institucionet financiare të çdo informacioni nga që ka të bëjë me monitorimin e kësaj përputhshmërie, si dhe për të vendosur sanksione në rastin e moszbatimit të të kërkesave të tilla, në përputhje me Rekomandimin 35. Mbikëqyrësit duhet të ketë kompetenca për të imponuar një gamë të sanksioneve disiplinore dhe financiare, duke përfshirë fuqinë për të hequr, kufizuar ose pezulluar licënsën e institucionit financiar, në rastet kur një gjë e tillë është e zbatueshme.

#### 28. Rregullimi dhe mbikëqyrja e DNFBPs

<sup>1</sup> Parimet Themelore për Mbikëqyrjen Efektive Bankare të publikuar nga Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare, objektivat dhe parimet për Mbikëqyrjen e Letrave me Vlerë të publikuara nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë dhe Parimet Themelore të Sigurimeve të publikuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve.



Të ashtuquajturat biznese dhe profesione jo-financiare (DNFBP) duhet të jenë subjekt i masave rregullatore dhe mbikëqyrëse të përcaktuara më poshtë.

- (a) Kazinotë duhet t'i nënshtrohen një regjimi të plotë rregullator dhe mbikëqyrës për të siguruar që ato i kanë zbatuar në mënyrë efektive të nevojshme masat PPP/ FT. Minimalisht:
- kazinotë duhet të jenë të liçensuara;
  - Autoritetet kompetente duhet të marrin masat e nevojshme ligjore ose rregullatore për të parandaluar kriminelët apo bashkëpunëtorët e tyre nga mbajtja, apo të qënit pronari përfitues, pasja e një funksioni të menaxhimit apo operator i një kazinoje.
  - Autoritetet kompetente duhet të sigurojnë që kazinotë janë të mbikëqyrura në mënyrë efektive për sa i përket përputhshmërisë me kërkesat PPP/FT.
- (b) Vendet duhet të sigurojnë se kategoritë e tjera të DNFBPs janë subjekt i sistemeve efektive për monitorimin dhe sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat PPP/FT. Kjo duhet të kryhet në bazë të nivelit të rrezikut nga (a) një mbikëqyrës ose (b) nga një organ i përshtatshëm vetë-rregullator (*Self Regulatory Body*), me kusht që një organ i tillë mund të sigurojë që anëtarët e tij përmbushin detyrimet e tyre për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Mbikëqyrësi ose organi vetë-rregullator gjithashtu duhet (a) të marrë masat e nevojshme për të parandaluar kriminelët apo bashkëpunëtorët e tyre nga të qënit të akredituar profesionalisht, pronari përfitues i një interesi të rëndësishëm ose kontrollues apo mbajtjen e një funksion të menaxhimit, p.sh. nëpërmjet vlerësimit të personave mbi bazën e një testi "të përshtatshëm dhe të duhur" (*fit and proper*), dhe (b) të ketë në dispozicion sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse në përputhje me Rekomandimin 35, për t'u vendosur në rastet e mosplotësimit të kërkesave PPP/FT.

## OPERACIONALE DHE ZBATIMI LIGJIT

### 29. Njësitë e Inteligjencës Financiare\*

Vendet duhet të krijojnë një Njësi të Inteligjencës Financiare (NjIF) që shërben si një qendër kombëtare për marrjen dhe analizimin e: (a) Raporteve të transaksioneve të dyshimta dhe (b) informacioneve të tjera që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, veprat lidhur me financim të terrorizmit si dhe për shpërndarjen e rezultateve të kësaj analize. Për të kryer siç duhet funksionet e veta, NjIF duhet të jetë në gjendje të marrë informacion shtesë nga subjektet raportuese dhe duhet të ketë qasje në informacionet financiare, administrative dhe agjensitë e zbatimit të ligjit.

### 30. Përgjegjësitë e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe atyre hetimore\*

Vendet duhet të sigurojnë që autoritetet e zbatimit të ligjit kanë përgjegjësi për pastrimin e parave dhe financimin e hetimeve terroriste brënda kuadrit të politikave kombëtare PPP/FT. Autoritetet e zbatimit të ligjit duhet që minimalisht në të gjitha rastet që lidhen me veprat kryesore penale që gjenerojnë të ardhura, të zhvillojnë paralelisht një hetim pro-aktiv financiar kur ndjekin pastrimin e parave, veprat shoqëruese të origjinës dhe financimin e terrorizmit. Kjo duhet të përfshijë rastet kur vepra penale ndodh jashtë juridiksionit të tyre. Vendet duhet të sigurojnë që autoritetet kompetente të kenë përgjegjësinë për identifikimin e shpejtë, gjurmimin dhe fillimin e veprimeve për të ngrirë dhe të konfiskuar pasurinë që është, ose mund të bëhet, objekt i konfiskimit, ose që dyshohet se është pasuri kriminale. Vendet duhet gjithashtu të përdorin, kur është e nevojshme, grupe ndërinstitucionale, të përhershëm ose të

STANDARTET NDËRKOMBËTARE MBI LUFTËN KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT përkohshëm, të specializuara në hetimet financiare ose pasurore. Vëndet, kur është e nevojshme, duhet të sigurojnë, hetime të përbashkëta me autoritetet përkatëse kompetente në vende të tjera.

### 31. Kompetencat e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe atyre hetimore.

Gjatë kryerjes së hetimeve të pastrimit të parave, veprave të origjinës dhe financimit të terrorizmit, autoritetet kompetente duhet të jenë në gjëndje të kenë qasje në të gjitha dokumentet dhe informacionin e nevojshëm dhe informatat që përdoren në këto hetime apo në ndjekjen penale dhe veprime që lidhen me to. Kjo duhet të përfshijë kompetencat për të përdorur masa të detyrueshme për dorëzimin e të dhënave të mbajtura nga institucionet financiare, DNFBP dhe personat e tjerë fizikë ose juridikë, për kontrollin e personave dhe objekteve, për të marrë deklaratat e dëshmitarëve, si dhe për sekuestrimin dhe marrjen e provave.

### 32. Korrierët e parasë\*

Vendet duhet të marrin masa për të zbuluar transportin fizik ndërkufitar të parasë dhe instrumenteve të negociueshme të mbajtësit, nëpërmjet një sistem deklarimi dhe / apo sistemi zbulimi.

Vendet duhet të sigurojnë që autoritetet e tyre kompetente kanë autoritetin ligjor për të ndaluar ose kapur paratë ose instrumentet e negociueshme të mbajtësit që dyshohen se janë të lidhura me financimin e terrorizmit, pastrimin e parave ose vepra penale të origjinës, ose që janë deklaruar në mënyrë të rreme.

Vendet duhet të sigurojnë që sanksionet në dispozicion, kundrejt personave të cilët bëjnë deklarata të rreme, janë efektive, proporcionale dhe bindëse. Në rastet kur paratë apo instrumentet e negociueshme janë të lidhura me financimin e terrorizmit, pastrimin e parave ose vepra penale të origjinës, vendet duhet të miratojnë masa, përfshirë edhe ato legislative në përputhje me Rekomandimin 4, të cilat do të mundësonin konfiskimin e parave apo instrumenteve.

## KËRKESAT E PËRGJITHSHME

### 33. Statistikat

Vendet duhet të mbajë statistika gjithëpërfshirëse për çështje që lidhen me efektivitetin dhe efikasitetin e sistemeve PPP/FT. Kjo duhet të përfshijë statistikat mbi raportet e transaksioneve të dyshimta të marra dhe të shpërndara; për hetimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, ndjekjeve penale dhe dënimeve; mbi pasuritë e bllokuar, sekuestruar dhe konfiskuar si dhe për ndihmë të ndërsjellë juridike ose kërkesave të tjera ndërkombëtare për bashkëpunim.

### 34. Udhëzime dhe reagimet

Autoritetet kompetente, mbikëqyrësit dhe organet vetë-rregullatore duhet të hartojnë udhëzime dhe të sigurojnë reagime, të cilat do të ndihmojnë institucionet dhe DNFBP në zbatimin e masave kombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe në veçanti në zbulimin dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta.

## SANKSIONET

### 35. Sanksionet

Vëndet duhet të sigurojnë se disponojnë një gamë sanksionesh efektive, proporcionale dhe bindëse, qoftë penale, civile ose administrative, për t'u zbatuar ndaj personat fizikë ose juridikë që janë subjekt i rekomandimeve 6 dhe 8 - 23, në rastet e moszbatimit të kërkesave të PPP/FT. Sanksionet duhet të jenë të zbatueshme jo vetëm për institucionet financiare dhe DNFBPs, por gjithashtu për drejtuesit dhe menaxherët e nivelit të lartë.

## G. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

### 36. Instrumentet ndërkombëtare

Vendet duhet të marrin hapa të menjëhershëm për t'u bërë palë dhe zbatuar plotësisht Konventën e Vjenës, 1988, Konventën e Palermos, 2000; Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, 2003; dhe Konventën për Financimin e Terrorizmit, 1999.

Aty ku është e aplikueshme, vendet gjithashtu janë të inkurajuara për të ratifikuar dhe zbatuar konventat e tjera ndërkombëtare, të tilla si Konventën e Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik, 2001; Konventën Ndër-Amerikane kundër Terrorizmit, 2002, dhe Konventën e Këshillit të Evropës mbi Pastrimin, Kërkimin, Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe për Financimin e Terrorizmit, 2005.

### 37. Ndihma e ndërsjellë ligjore

Vendet duhet të sigurojnë në mënyrë të shpejtë, të dobishme dhe efektive gamën me të gjerë të mundshme të ndihmës së ndërsjellë juridike në lidhje hetimet, ndjekjen penale dhe veprimet hetimore që lidhen me to, në drejtim të pastrimit të parave, veprave penale të origjinës dhe financimit të terrorizmit. Vendet duhet të kenë një bazë të përshtatshme ligjore për sigurimin e ndihmës dhe kur është e mundur, duhet të kenë në dispozicion traktate, marrëveshje apo mekanizma të tjerë për të rritur bashkëpunimin. Në veçanti, vendet duhet të:

- (a) Mos ndalojnë, ose të vendosin kushte të paarsyeshme ose tejet kufizuese në dhënien e ndihmës së ndërsjellë juridike.
- (b) Sigurojnë se ata kanë procese të qarta dhe efikase për përparësinë e duhur dhe zbatimin e kërkesave të ndërsjella për ndihmë ligjore. Vendet duhet të përdorin një autoritet qendror, apo një mekanizëm tjetër zyrtar, për transmetimin efektiv dhe zbatimin e kërkesave. Për të mbikëqyrur ecurinë e kërkesave, duhet të mbahet një sistem i administrimit të çështjeve.
- (c) Mos refuzojnë përmbushjen e një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike, për arsyen e vetme që vepra konsiderohet se përfshin çështjet fiskale.
- (d) Mos refuzojnë përmbushjen e një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike, për arsye se në bazë të ligjit nga institucionet financiare apo profesionet e lira (DNFBP) kërkohet të ruajnë sekretin ose konfidencialitetin (me përjashtim të rasteve kur informacioni përkatës që kërkohet, ruhet në kushtet kur zbatohet privilegji apo sekreti profesional).
- (e) Në funksion të mbrojtjes së integritetit të hetimit të ruajnë konfidencialitetin e kërkesave të ndërsjella për ndihmë ligjore që ata marrin dhe të dhënat e përfshira në to, në përputhje me parimet themelore të legjislacionit vëndas. Nëse vendi të cilit i drejtohet kërkesa nuk mund të përmbushë detyrimin e konfidencialitetit, duhet të informojë menjëherë shtetin kërkuës.

Vendet duhet të japin asistencë të ndërsjellë ligjore, pavarësisht mungesës së kriminalitetit të dyfishtë (*dual criminality*), nëse ndihma nuk ka të bëjë me veprime shtrënguese. Vendet duhet të marrin parasysh miratimin e masave të tilla që mund të jenë të nevojshme për t'u mundësuar atyre një fushë të gjerë të asistencës në mungesë të kriminalitetit të dyfishtë.

Nëse kriminaliteti i dyfishtë përbën kusht për asistencë të ndërsjellë ligjore, ajo kërkesë duhet të konsiderohet si e përmbushur pavarësisht nëse të dy vendet e përcaktojnë veprën brenda të njëjtës kategori të veprës penale, ose e emërtojnë veprën me të njëjtën terminologji, me kusht që të dy vendet të penalizojnë sjelljen që qëndron në themel të veprës.

Vendet duhet të sigurojnë që, kompetencat dhe teknikat hetimore të kërkuara në Rekomandimin 31 dhe çdo kompetencë apo teknikë në dispozicion të autoriteteve kompetente, të tilla si:

- (a) të gjitha ato që lidhen me marrjen, kërkimin dhe konfiskimin e dokumenteve, informacionit ose provave (përfshirë të dhënat financiare) nga institucionet financiare ose persona të tjerë, si dhe marrjen e deklaratave të dëshmitarëve dhe
- (b) një gamë të gjerë të kompetencave të tjera dhe teknikave hetimore;

të jenë gjithashtu në dispozicion për përdorim në përgjigje të kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe në përgjigje të kërkesave të drejtpërdrejta që homologët vëndas marrin nga autoritetet e huaja të zbatimit të ligjit apo ato gjyqësore, nëse një gjë e tillë është në përputhje me kuadrin e tyre të brendshëm.

Për të shmangur konfliktet e juridiksionit, duhet të merret në konsideratë krijimi dhe zbatimi i mekanizmave për përcaktimin e vendit më të mirë për ndjekjen penale të të akuzuarve për ato raste kur ata janë subjekt i ndjekjes penale në më shumë se një vend.

Kur bëjnë kërkesa për ndihmë të ndërsjelle ligjore, vendet duhet të bëjnë përpjekjet maksimale për të siguruar informacion të plotë faktik dhe ligjor që do të lejojë ekzekutimin në kohë dhe efikas të kërkesave, duke përfshirë çdo nevojë urgjente dhe për dërgimin e kërkesave duhet të përdoren mjete të shpejta. Vendet duhet që para se të dërgojnë kërkesa, të bëjnë përpjekjet maksimale për të përcaktuar kërkesat ligjore dhe formalitetet për të marrë ndihmë.

Autoritetet përgjegjëse për ndihmën e ndërsjellë juridike (p.sh. një Autoritet Qendror), duhet të pajisen me burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe teknike. Vendet duhet të sigurojnë që punonjësit e këtyre autoriteteve zbatojnë standarde të larta profesionale duke përfshirë ato në lidhje me konfidencialitetin, të kenë integritet të lartë dhe aftësitë e duhura.

### 38.Ndihma e ndërsjellë ligjore: ngrirja dhe konfiskimi\*

Vendet duhet të sigurojnë që ata kanë autoritetin për të ndërmarrë veprime të shpejta në përgjigje të kërkesave nga vendet e huaja për të identifikuar, bllokuar, sekuestruar dhe konfiskuar pasurinë e pastruar; të ardhurat nga pastrimi i parave, veprave penale të origjinës dhe financimin e terrorizmit; instrumenteve të përdorura në, ose të destinuara për kryerjen e këtyre veprave penale, ose pasuri në vlerë korresponduese. Ky autoritet duhet të përfshijë aftësinë për t'iu përgjigjur kërkesave të bëra për procedimet e konfiskimit pa dënime dhe procedurat e lidhura me to, përveç atyre rasteve kur kjo është në kundërshtim me parimet themelore të legjislacionit të tyre të brendshëm. Vendet duhet të kenë

mekanizma efektive për menaxhimin e nje prone të tillë, instrumentet apo pronën e vlerës korresponduese dhe marrëveshjet për koordinimin sekuestrimin dhe procedurat e konfiskimit, të cilat duhet të përfshijnë ndarjen e pasurive të konfiskuara.

### 39. Ekstradimi

Vendet duhet të ekzekutojnë në mënyrë konstruktive dhe efikase, pa vonesa të pajustificuara, kërkesat për ekstradim në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Vendet duhet të marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që ata nuk ofrojnë strehë të sigurtë për individët të ngarkuara me financimin e terrorizmit, akteve terroriste apo organizata terroriste. Në veçanti, vendet duhet:

- a) Të sigurojnë që pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit janë vepra të ekstradueshme;
- b) Të sigurojnë që ata kanë procese të qarta dhe efikase për ekzekutimin në kohë të kërkesave të ekstradimit përfshirë vendosjen e prioriteteve sipas rastit. Për të monitoruar progresin e kërkesave duhet mbahet një sistem për administrimin e çështjeve;
- c) Të mos vendosin kushte të paarsyeshme ose padrejtësisht kufizuese për ekzekutimin e kërkesave;
- d) Të sigurojnë një kornizë adekuate ligjore për ekstradim.

Çdo vend duhet të ekstradojë shtetasit e vet, ose në se një vend nuk e bën këtë bazuar vetëm në kombësinë, ai duhet që me kërkesë të vendit që kërkon ekstradimin, t'jua paraqesë çështjen pa vonesë, autoriteteve të veta kompetente për qëllime të ndjekjes penale të veprave penale të përcaktuara në kërkesë.

Këto autoritete duhet të marrin vendimin e tyre dhe të kryejnë procedurat e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e çdo veprë tjetër të një natyre serioze sipas ligjit të brendshëm të atij vendi. Vendet e interesuara duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, në mënyrë të veçantë në aspektet procedurale dhe provave për të siguruar efikasitetin e ndjekjeve të tilla penale.

Në se kriminaliteti i dyfishtë kërkohet për ekstradimin, ajo kërkesë duhet të konsiderohet si e përmbushur pavarësisht nëse të dy vendet e përcaktojnë veprën brenda të njëjtës kategori të veprës penale, ose e emërtojnë veprën me të njëjtën terminologji, me kusht që të dy vendet të penalizojnë sjelljen që qëndron në themel të veprës.

Në përputhje me parimet themelore të legjislacionit të brendshëm, vendet duhet të kenë mekanizma të thjeshtuar të ekstradimit, të tillë që të lejojnë transmetimin e drejtpërdrejtë të kërkesave për arrestime të përkohshme ndërmjet autoriteteve përkatëse, ekstradimin e personave bazuar vetëm në urdhër të arrestimeve apo vendimeve të gjykatave, ose zbatimin e një ekstradimit të thjeshtuar të personave të cilët heqin dorë nga procedurat formale të ekstradimit

Autoritetet përgjegjëse për ekstradim duhet të pajisen me burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe teknike. Vendet duhet të përcaktojnë proceset për të siguruar që punonjësit e këtyre autoriteteve zbatojnë standarde të larta profesionale (duke përfshirë standardet në lidhje me konfidencialitetin), kanë integritet të lartë dhe aftësitë e duhura.

### 40. Forma të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar\*

Vendet duhet të sigurojnë, në mënyrë konstruktive dhe efikase, pa vonesa të pajustificuara, gamën më të

gjërë të bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me pastrimin e parave, veprat penale të origjinës dhe financimin e terrorizmit.

Vendet mund ta bëjnë këtë qoftë në mënyrë spontane apo me kërkesë dhe bashkëpunimi duhet të jetë i bazuar në ligj.

Vendet duhet të autorizojnë autoritetet e tyre kompetente për të përdorur mjetet më efikase për të bashkëpunuar. Nëse një autoriteti kompetent i nevojitet marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe ose marrëveshje të tilla si një Memorandum Mirëkuptimi, ato duhen negociuar dhe nënshkruar në mënyrë të duhur me një gamë të gjerë të homologëve të huaj.

Autoritetet kompetente duhet të përdorin kanale të qarta apo mekanizma për transmetimin efektiv dhe zbatimin e kërkesave për informacion ose llojet e tjera të ndihmës. Autoritetet kompetente duhet të kenë procese të qarta dhe efikase për vendosjen e prioritetëve dhe ekzekutimin në kohë të kërkesave, si dhe për ruajtjen e informacionit të marrë.